



**QENDRA E STUDIMEVE
DHE PUBLIKIMEVE
PËR ARBËRESHËT**

**QENDRA KOMBËTARE
E LIBRIT DHE LEXIMIT**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

PËR

**ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA
NDËRMJET**

**QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR
ARBËRESHËT DHE**

QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

PREAMBUL

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen, *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë që ka bashkëpunimi me komunitetet shqiptare në diasporë në ndërtimin e urave lidhëse me vendlindjen;

Për të evidentuar kontributin që ka komuniteti arbëresh në ruajtjen e gjuhës, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare pa pasur një lidhje të vazhdueshme me vendin e origjinës;

Me dëshirën për të nxitur studimet dhe publikimet kërkimore shkencore dhe rritur cilësinë e tyre duke përfshirë akademikët dhe studiuesit e kësaj fushe kërkimore;

Me synimin për të nxitur bashkëpunimin midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe përkujtimin e ngjarjeve më të rëndësishme historike të komunitetit arbëresh, nxitjen e leximit dhe të krijimtarisë të lidhur me promovimin e letërsisë arbëreshe dhe të autorëve që studiojnë letërsinë arbëreshe brenda dhe jashtë vendit;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur

Marrëveshja.

Neni 1

Baza ligjore

Palët do të bashkëpunojnë në zbatim dhe respektim të ligjit nr. 92/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 16/2018 “Për diasporën””, Ligjit nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 601, datë 04.09.2019 “Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”, VKM-së nr. 24, datë 16.01.2019 “Për krijimin, Organizimin dhe Funkcionimin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit”.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është realizimi i konferencave shkencore, aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta, të cilat do t’i shërbejnë shkëmbimit të eksperiencave të ndërsjellta ndërmjet dy institucioneve. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit do të ofrojnë përdorimin e ambjenteve të tyre për konferenca dhe aktivitete.

Neni 3

Objekti i bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Promovimin e botimeve të QSPA-së dhe të QKLL-së;
- b. Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta brenda vendit si dhe në Bashkimin Evropian, në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm;
- c. Organizimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- d. Përkujtimin e datave dhe autorëve shqiptarë që përfaqësojnë trashëgimi historike e letrare në veprën e tyre;
- e. Përkujtimin dhe mbështetjen e krijimtarisë së shkrimtarëve arbëreshë të traditës si dhe të diasporës së re në organizmin e konferencave të përbashkëta dhe ekspozitave.

Neni 4

Kostot financiare

1. Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj do të përballohen nga buxheti i të dy institucioneve, në përpjesëtim të drejtë sipas zërave buxhetorë të parashikuar, duke iu nënshtruar legjislacionit në fuqi.
2. Kostot financiare janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore mbi veprimtaritë që Palët kanë në dispozicion.

Neni 5

Kohëzgjatja e dhe ndryshimi

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ajo mund të ndryshojë vetëm me dakordësi të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 7

Hyrja në Fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe dy pranë Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi ditën e sotme, 19.04.2021 dhe lidhet pa afat.

PËR
QENDRËN E STUDIMEVE DHE
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

DREJTOR
Diana KASTRATI

PËR
QENDRËN KOMBËTARE TË LIBRIT
DHE LEXIMIT

DREJTOR
Alda BARDHYLI